

Marrëveshje Bashkëpunimi
midis

Universitetit Bujqësor të Tiranës, Shqipëri (UBT)

dhe

Universitetit të Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës në Vjenë
(BOKU)

Historiku:

Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Jetës në Vjenë (BOKU) dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) filluan bashkëpunimin e tyre me një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) të nënshkruar nga të dyja palët më 1 tetor 2021, për të mbështetur UBT-në në strategjinë e saj të titulluar "UBT 2030" nga BOKU për t'u bërë një Universitet Bujqësor lider në rajonin e Ballkanit. Ky memorandum nuk parashikonte asnjë detyrim apo çështje financiare.

Që nga vitit 2021 janë zhvilluar aktivitete të ndryshme në fushën e kërkimit dhe mësimdhënies nga të dyja palët dhe është hartuar një projekt-propozim i plotë i titulluar "Zbatimi i Strategjisë së UBT-se 2030". Në këtë propozim janë përcaktuar struktura e mbështetjes, afati kohor dhe çështjet financiare për zbatimin e "Strategjisë AUT 2030" me ndihmën e Universitetit BOKU.

Ky propozim është miratuar nga pala austriake nga Ministritë Federale të (i) Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit dhe (ii) Bujqësisë, Pylltarisë, Rajoneve dhe Menaxhimit të Ujërave, si dhe nga pala Shqiptare nga Ministritë për (iii) Arsimin dhe Sportin dhe (iv) Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Me këtë miratim sigurohet mbështetja financiare sipas planit të projektit dhe nënshkrimi zyrtar i kësaj marrëveshje u bë më 15 prill 2024 në Vjenë, Austri.

Paragrafi 1

Universiteti BOKU është një organ juridik i pavarur. Për rrjedhojë, qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të formalizojë ligjërisht bashkëpunimin midis dy universiteteve në përputhje me dokumentet ekzistuese për të nisur projektin "Zbatimi i Strategjisë së UBT-së 2030".

Paragrafi 2

Marrëveshja bazohet në dokumentet e mëposhtme, të cilat janë pjesë integrale e bashkëpunimit:

-Shtojca 1: Memorandumi i Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e Universiteteve në fushat e Bujqësisë, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave, i cili rregullon mbështetjen financiare nga Shteti i Austrisë dhe Shteti i Shqipërisë bazuar në projektin "Zbatimi i strategjisë së AUT 2030" (Shtojca 2).

-Shtojca 2: Projekt-propozimi "Zbatimi i strategjisë së UBT-së 2030" me përshkrimin e detajuar të ngarkesës së punës duke përfshirë detajet financiare dhe afatet kohore.

Paragrafi 3

Të dyja palët bien dakord:

- UBT është përgjegjëse për ngarkesën e punës, administrimin dhe për dorëzimin raporteve në kuadër financimit siguruar nga buxheti i Qeverisë Shqiptare (shih Shtojcën 2).
- BOKU është përgjegjëse për ngarkesën e punës, administrimin dhe për dorëzimin raporteve në kuadër financimit siguruar nga buxheti i Qeverisë Austriake (shih Shtojcën 2).
- Çdo aktivitet financiar që nuk është parashikuar në marrëveshjen aktuale të projektit (shih Shtojcën 2) dhe që mund të pësojë ndryshime gjatë zhvillimit të projektit, do të rregullohet përmes hartimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve të reja për çdo rast të veçantë.

Paragrafi 4

Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar më 15 Prill 2024 (Shtojca 1) nga Shteti i Austrisë dhe Shteti i Shqipërisë dhe bazuar në projektin "Zbatimi i strategjisë së UBT 2030" (Shtojca 2), rregullon çështjet financiare në vijim:

- Kostot e projektit për BOKU, në vlerën prej 1,026,000 Euro, mbulohen nga Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit dhe vihen në dispozicion në kuadër të marrëveshjeve të performancës ndërmjet Ministrisë dhe BOKU.
- Kostot e projektit për AUT, në vlerën prej 1,950,000 Euro, mbulohen nga fondet e Shtetit të Shqipërisë brenda procesit të ndërkombëtarizimit të studimeve dhe në përputhje me rregullat e menaxhimit të sistemit buxhetor, për një periudhë prej 4 vitesh.

Paragrafi 5

Ky marrëveshje hynë në fuqi nga data e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi gjatë gjithë periudhës së projektit, por jo më vonë se fundi i vitit 2030. Çdo ndryshim i ardhshëm në këtë marrëveshje behet me shkrim dhe kërkon pëlqimin e ndërsjellë të të dyja palëve dhe hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj.

Paragrafi 6

Kjo kontratë mund të anulohet në çdo kohë, nga njëra palë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër. Pala që dëshiron të anulojë këtë kontratë duhet të njoftojë palën tjetër me shkrim të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara duke parashtruar arsyetimin dhe qëllimin e saj.

Paragrafi 7

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që lind nga ose në kuadër të marrëveshjes, palët do të përpiqen ta zgjidhin çështjen në mënyrë miqësore përmes konsultimeve të ndërsjella.

Paragrafi 8

Kjo marrëveshje nuk rregullon asnjë të drejtë ligjore ose financiare përtej atyre të përshkruara në propozim (shih Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2) dhe do të zbatohet në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nënshkruar në Tiranë, 28.05.2024

Eva Schulev-Steindl
Rektore e BOKU-t

Fatbardh SALLAKU
Rektori UBT-së

